

VENDIM
Nr. 9/2012

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR DHE CAKTIMIN E OBJEKTIT, PËRBËRJES DHE AFATIT TË KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË ZOTIT KRESHNIK SPAHIU, ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 2/2012, DATË 26.1.2012

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për ngritjen e komisionit hetimor dhe caktimin e objektit, përbërjes dhe afatit të komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 2/2012, datë 26.1.2012, zgjatet për një periudhë 2-javore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 16.2.2012